



KY KONTINGJENT PËRBËHEJ NGA 32 USHTARAKË



Kthehet nga misioni në Afganistan Kontingjenti OMLT-2

Ministri Imami: Në këtë mision Forcat tona të Armatosura patën drejtimin dhe kontrollin operacional, ku përfshiheshin edhe trupat e Gardës së New Jersey. Ky ishte një nder sepse tregon besimin e madh të SHBA, të Departamentit të Mbrojtjes, të FA të SHBA...

faqe 4

U DISKUTUA PAKETA E KONTRIBUTEVE PËR '13-'14

Takim për përcaktimin e nivelit të angazhimit të FA në operacionet ndërkombëtare

faqe 7

ANALIZA

GLOBALIZIMI DHE TERRORIZMI

DOC.DR. MUHAMED RACAJ,
GJENERALBRIGADE

faqe 114-15

PËR SISTEMIN E GRADIMEVE, KUALIFIKIMEVE DHE STËRVITJEN NË FA

Gjeneralmajor Gjunkshi takim me atashetë ushtarake të NATO-s të akredituar Shqipëri

faqe 6

LETRA E GJENERAL MARTIN E. DEMPSEY, PËR SHEFIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH-SË



100-vjetori i Pavarësisë, kryetari i shefave të Shtabeve të SHBA uron gjeneralmajor Gjunkshin

faqe 6

NGA 2009-TA DERI NË TETOR 2012 JANË DEMILITARIZUAR DHE EKSPORTUAR 74869 TON
MUNICIONE DHE LËNDË PLASËSE E BOSHATISUR 58 MAGAZINA DHE TUNELE

Demontimi i municioneve të tepërta një proces i suksesshëm i FA

Ministri Imami: Për të gjitha depot, magazinat dhe pronat e tjera që dalin jashtë Planit të Përhapjes të FA të përgatitet dokumentacioni i plotë, korrekt dhe serioz, një dosje e qartë që shteti shqiptar të mos humbasë asnjë metër katror, sikurse edhe ka ndodhur në vitet e shkuara dhe të gjitha këto t'i kalohen Ministrisë së Ekonomisë dhe mandej Ministrisë së Financave, që bën privatizimin e këtyre pronave publike



faqet 3

Në faqen zyrtare të MM janë pasqyruar mbi 700 prona, në mënyrë që të gjithë qytetarët shqiptarë ta dinë që këto prona janë të hapura Komisioni për Sigurinë Kombëtare seancë dëgjimore për pronat e Ministrisë së Mbrojtjes

MINISTRI IMAMI: Deklarata ime e parë e rëndësishme është që Ministria e Mbrojtjes nuk shet prona, por me këtë proces merret Ministria e Ekonomisë institucion që është përgjegjëse në këtë proces, ndërsa Ministria e Financave nëpërmjet Agjencisë së Ankandeve bën shitjen përfundimtare të tyre. Detyra jonë është që vetëm t'i dorëzojmë pronat e tepërta me aq metra katrorë që ka pasur në vitin 1990



faqe 4-5

"GJITHÇKA NË DISPOZICION TË PËRGATITJES PËR PARADËN USHTARAKE"

Për një krenari

Gjunkshi në takimin "Për organizimin dhe zhvillimin e Paradës Ushtarake me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë dhe FA"



Të jesh pjesëtar i paradës së 100 vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar është një krenari e madhe. Vetëm një herë në jetë te jepet mundësia të kesh këtë fat. Ndaj të gjithë trupat pjesëmarrëse duhet ta konsiderojnë njëkohësisht një përgjegjësi dhe një privilegj të jashtëzakonshëm këtë eveniment". Kështu e fillon porosinë e tij për të gjithë trupat pjesëmarrëse në Paradën e 28 nëntorit 2012, gjeneralmajor Zyber Dushku. Më datën 7 nëntor 2012 është pse shiu binte pa pushim stërvitja rreshtore për paradën e 100 vjetorit po vazhdonte me intesitet. Nën tingujt muzikore të marsheve të Orkestrës Frymore të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Zyber Dushku, Komandanti i Stërvitjes së trupave pjesëmarrëse në...

faqe 8-9

U DIPLOMUAN 11 OFICERË DHE 201 USHTARË PROFESIONISTË

Ceremoni diplomimi dhe Certifikimi në Shkollën e Trupës në Bunavi

faqe 11

LETRA E GJENERALLEJTËNANT KASTRATIT

Pjesëmarrja në A5, komandanti i FSK-së letër falënderimi gjeneralmajor Gjunkshit

faqet 2

STUDIMI

Evolucioni drejt suksesit i doktrinës së forcave tokësore në shekullin e XXI-të

faqe 10

AKTIVITETI NË KUADËR TË 100 VJETORIT



Ekipit të komunës Farkë i jepet kupa "Kapiten Feti Vogli", Dëshmor i Atdheut

Gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi: "Në këtë ndeshje ju treguat shpirtin luftarak, atë shpirt që kapiten Feti Vogli e demonstroi në fushën e luftimit. Le të shërbejë kjo nismë, kjo ide shumë e mirë e organizatorëve, për ta ngritur akoma edhe më lart figurën e Dëshmorit të Atdheut Feti Vogli, pasi ai tani nuk është vetëm i Baldushkut, por është Dëshmor i të gjithë Shqipërisë

faqe 5

GLOBALIZIMI DHE TERRORIZMI



DOC.DR. MUHAMED RACAJ,
GJENERALBRIGADE

Cfarë është thelbi i kuptimit dhe diferencimit të termave? Qëllimet janë të ndryshme, ndërsa shkalla dhe shpejtësia e transformimit janë të njëjta. Cila prej këtyre dukurive është udhëheqëse dhe cila ndjekëse, ose ndoshta të dyja zhvillohen në mënyrë paralele, reciprokisht të varura apo jo? Karakteristikat me të cilat veçohen këta a adaptohen në një dimension tjetër dhe në një dritë më ndryshe? E gjithë kjo mund të rishikohet me dimensionet e globalizimit dhe format e terrorizmit.

Qasjet teorike të globalizimit janë të ndryshme, madje edhe krejtësisht të kundërta. Pluralizmi teorik nuk buron aq shumë nga mohimi i fakteve të globalizimit, se sa nga dilema a është “një epokë ndryshe”, ose është një vazhdimësi e procesit të filluar në kohën moderne. Globalizimi ka aq shumë teori sa ka teoricienët që merren me të, madje asnjë teori nuk i përmban të gjitha aspektet e procesit të globalizimit. Prandaj, me bujarisht do të ishte të kuptuarit në vend të përcaktimit të globalizimit. Secila teori për ndarje të globalizimit është relative dhe e kushtëzuar që çon në aspekte relative dhe të kushtëzuar të globalizimit.

Pyetja që lind është: A mundet globalizimi si një fenomen në mënyrë të pashmangshme të mbikëqyret në aspekte parciais, dhe jo vetëm në një tërësi? Arsytimi i dilemës është i dyfishtë. Së pari, për shkak se globalizimi është një koncept gjithëpërfshirës, i njëjti ne fjalë mundet si fenomen të mbikëqyret në disa aspekte të ndryshme të lidhura dialektisht. Së dyti, është fakti se të gjitha aspektet e globalizimit nuk kanë ndodhur në të njëjtën kohë me qenien njerëzore, por ajo mori vite, dekada, apo edhe shekuj. Aspektet të globalizimit në të vërtetë përfaqësojnë dimensionet e saj dhe kushtimisht ne mund të dallojmë katër dimensione themelore të globalizimit të cilët në kornizat e tyre mund të paraqesin këtë fenomen dhe duke i trajtuar proceset si pasojë të këtij fenomeni. Dimensionet e globalizimit janë: dimensionin ekologjik, ushtarak, socio-politik dhe dimensionin ekonomik.

Dimensioni ekologjik është krijuar më herët, në një kohë kur



shoqëritë kanë marrë format e tyre. Ndotja e mjedisit, uji, ajrit dhe tokës, si edhe rritja e numrit të banorëve të planetit, janë disa nga format e para të globalizimit. Me dimensionin ekologjik të globalizimit nuk nënkuptojmë vetëm rrënimin e ekosistemit, por edhe përhapjen e sëmundjeve të ndryshme, të cilat me një shpejtësi marramendëse janë transmetuar prej një pjesë të botës në një tjetër. Pikërisht ky dimension në raport me tri tjerët të lartpërmendur, na jep të drejtën të themi se globalizimi nuk është një fenomen i ri, por ai ka ndodhur në periudhat më të hershme të qytetërimit njerëzor.

Dimensionin i dytë i globalizimit është globalizimi ushtarak, i cili format e para i merr nga luftërat po ashtu të para të zhvilluara. Kërcënimi dhe përdorimi i forcës janë shpërndarë në rajone të ndryshme, madje edhe në kontinente. Jo të rralla janë dhe vërejtjet që Aleksandri i Madh ishte njëri nga ato që në shtizën tij të këmbësorisë e bëri globalizimin e parë ushtarak, duke e bashkuar botën përëndimore e asokohe me lindjen.

A është në fakt Helada hapësira e vjetër ku është krijuar globalizimi ushtarak, ose rrënjët edhe më vjetra? Luftimi në emër të idealeve të shenjta të demokracisë a ka filluar në periudhat e hershme të qytetërimit evropian? Këto janë pyetje ende të hapura për të cilat mund të jepen përgjigje të ndryshme, por ajo që mbetet e padiskutueshme është se dimensionin ushtarak i globalizimit ka mbetur më shumë se aktuale sot dhe padyshim që është një komponentë shumë e rëndësishme e rendit të ri botëror.

Dimensioni socio-politik i globalizimit është i bazuar në zgjerimin e njohurive të caktuar, besimeve, vlerave, standardeve morale, bindjet fetare, dhe të tjera. Sigurisht që kjo përfshin përhapjen e ideve politike, ekonomike, ligjore dhe idealeve të tjera. Demokracia në shumicën e vendeve moderne nuk ka lindur brenda natës, por ajo ka një histori të gjatë, e cila është e bazuar në përhapjen e ideve të ndryshme.

Mendimtarët e parë jetët e tyre i përkushtojnë debateve për punim më të mirë, krishterimi jo rastësisht u bë feja më gjithëpërfshirëse e epokës moderne, me numrin më të madh të pelegrinëve, ekonomia liberale gjegjësisht neoliberal nuk është bërë papritmas forma dominuese e rregullimit ekonomik falë ndonjë fuqie supreme. Është imponuar nevoja për njerëzit të cilët jetonin në pjesë të ndryshme të botës, në distanca të gjata, për të pranuar vlerat e caktuara, bindjet dhe idetë, dhe kështu të përfitojnë njohuri të caktuara të cilat më tej i kanë përcaktuar jetët e tyre, shoqëritë dhe shtetet për të rregulluar ato ashtu si bëjnë sot.

Dimensioni ekonomik i globalizimit është ai që shumica e shkencëtarëve sot merren me të. Një nga arsytet mund të jetë se rendi i ri botëror ekonomik është i bazuar në një numër të madh të kompanive multinacionale që shpesh kanë buxhete më të mëdha se sa buxhetet shtetërore të disa shteteve ekzistuese. Kompanitë multinacionale nuk janë vetëm subjekte ekonomike, por edhe aktorët tanimë të rëndësishme, me ndikim të madhe dhe të domosdoshëm në rendin global. Rendi botërorë gjithëpërfshirës bazohet në ekzistencën e kompanive të këtyra, të cilat nëpërmjet kufijve nuk transportojnë vetëm mall dhe kapital, por edhe teknologji të ndryshme. Komponentë e dytë e rëndësishme e dimensionit ekonomik të globalizimit janë financat botërore dhe institucionet ekonomike. Ndikimi i këtyre institucioneve në politikën e shumicës së vendeve në botë është padyshim i dukshëm dhe progresivisht rritet ashtu si fuqia ekonomike dhe influenca e një shteti të caktuar bie.

Globalizimi është një fenomen që është aq i vjetër sa edhe vet shoqëria njerëzore, por që tiparet e saj të plota lulëzojnë në epokën moderne, nga gjysma e dytë e shekullit të nëntëmbëdhjetë e deri me sot. Ky proces sot mbulon të gjitha sferat e ekzistencës njerëzore, dhe njëkohësisht përcakton proceset politike, ekonomike, sociale, ligjore

dhe të tjera dhe marrëdhëniet ku përfshihen individët, organizatat, shtetet dhe subjektet e tjera kombëtare, rajonale, ndërkombëtare apo globale, gjegjësisht aktorët. Kjo do të thotë se globalizimi ndikon në të gjitha proceset dhe marrëdhëniet, në të gjitha nivelet horizontale dhe vertikale.

Format e terrorizmit

Terrorizmi është një çështje shumë komplekse sociale për të cilin ka shumë pak shpjegime shkencore. Në marrëdhëniet ndërmjet shkencës dhe politikës gjithmonë politika ka dominuar në kurriz të shkencës, ndërsa shkenca ka qenë vetëm një shërbëtor i varur për qëllimet të politikës. Parimi i objektivitetit në shkencat shoqërore është i bazuar në pamjen e vetëdijesuar dhe rimarrjen e qëndrimeve në favor të shoqërisë, gjegjësisht bazohet në thjeshtimin dhe aplikimin e parimit - çfarë nuk është e rëndësishme për shtetin, nuk është e rëndësishme as për shkencën. Dimensionin global i terrorizmit është edhe veçoria e tij e re dhe e rëndësishme, ndërsa nevoja për hulumtimin dhe definimin e tij proporcionalisht rritet me fenomenin global të terrorizmit. Nuk ekziston asnjë definicion i terrorizmit që është i pranuar në të gjithë botën, dhe për këtë arsye ne nuk e dimë se ndaj kujt luftojmë. Në përkufizimin e terrorizmit, ka sërë probleme objektive për shkak se ai është një fenomen kompleks i zhvilluar që ka manifestime të ndryshme dhe të shumtë.

Shkalla e lartë e kompleksitetit është i shoqëruar dhe me një shkallë të lartë të ndryshueshmërisë. Disa shtete nuk duan që terrorizmi të jetë i përcaktuar sepse ashtu ai ua mundëson plotësimin e interesave të veçanta të tyre politike. Të tjerët, të cilët duan që ai të jetë i përcaktuar, udhëhiqen nga pikëpamja e tyre për terrorizmin si një instrument për të arritur interesat e tyre. Mungesa e përkufizimit është e kushtëzuar nga diversiteti dhe kundërshmëria e interesave politike të opozitës, si dhe nga ekzistenca e standardeve të dyfishta dhe moralit jo të barabartë në politikën ndërkombëtare.

bëtare, veçanërisht nga ana e fuqive të mëdha. Mos ekzistenca e mundësisë për definimin e fenomenit terrorizëm Mungesa e aftësisë për të përcaktuar fenomenin e terrorizmit, na drejton në përcaktimin e tij të kuptueshëm dhe në rishikim e të njëjtit nëpërmjet disa formave manifestuese të tij.

Terrorizmi ekologjik në fillim të shekullit XXI është bërë kërcënim i gjerë i njerëzimit. Zhvillimi i industrisë dhe teknologjisë në fakt rrit rrezikun e përdorimit eventual të armëve nukleare nga ana e organizatave terroriste në mbarë botën. Terrorizmi ekologjik si një formë e terrorizmit përbëhet nga terrorizmi bërthamor, kimik dhe biologjik.

Kjo formë e terrorizmit është karakteristike sepse në aktivitetet e saj përdorë “burimet si mjete” dhe “burimet si qëllim.” Kur është fjala për “burimet si një mjet,” ky lloj i terrorizmit përdoret kur burimet ekologjike shfrytëzohen si transmetues destruktivë të agensave dhe grimcave të rrezikshme tek popullsia.

Kur duke përdorur “burime si një qëllim,” terroristët sulmojnë direkt në objektivin, për shembull, mund të hedhin në erë një digë dhe të përmbysin një ose më shumë qytete. Tani për tani, këto lloje të sulmeve janë atipike, por kjo nuk do të thotë se janë të përjashtuar në të ardhmen. Terrorizmi ekologjik ka tre forma dhe atë: përdorimi i armëve nukleare kundër njerëzve (forma gjenocidale), përdorimi i armëve nukleare ndaj kafshëve shtëpiake dhe bimëve të kultivuara (formë zoodike) dhe aktivitetet terroristike duke aplikuar armët nukleare ndaj mjedisit (formë ekociden). Terrorizmi ekologjik përfaqëson përdorimin e armëve nukleare me qëllim të shkatërrimit të sëmundjeve dhe shkatërrimin e një popullsie të caktuar të njerëzve, të kafshëve dhe bimëve apo të ndonjë pjesë të planifikuar të mjedisit për arsye politike. Marrja e vendimeve të këtyra shkakton drithërim, frikë, dhe panik në mesin e njerëzve, frikësimi gjegjësisht kërcënim të qeverisë ku aplikohen këto aktivitete terroriste ekologjike.

Terrorizmi Vetëvrasës po shfaqet si një kërcënim i luftës së sotme bashkëkohore që tenton të reduktojë numrin e ushtarëve të plagosur dhe viktimave kolateral. Në njëzet vitet e fundit u intensifikua kjo formë e terrorizmit – sakrifikimi i vetëdijshëm i jetës së tyre, në mënyrë që të arrihen qëllime të caktuara politike. Sulmet vetëvrasëse nuk janë një shpikje e shekullit të njëzetë. Vetëvrasjet e para të dokumentuara dy mijë vjet më parë ishin anëtarë të një sekti çifut Ziloti dhe Shikari në Judën e lashtë, në luftën kundër romakëve. Në fillim të shekullit të 20-të me zbulimin e dinamitit, sulmet vetëvrasëse filluan të aplikojnë anarkistët rusë.

Vetëvrasjet e para të organizuar mbas së cilave qëndrojnë shtetet, të cilët për qëllim kanë pasur luftëra të caktuara për herë të parë kanë ndodhur kah fundi i të Luftës së Dytë

Botërore, me fluturimet e pilotëve Kamikaze japoneze kundra caqeve të mëdha amerikane artizanale. Në Perëndim ekziston mendimi se një sulmues vetëvrasës është një person i mendimit fanatik me mentalitet të ulët mendor.

Analizat e terroristëve vetëvrasës të cilët rrëmbyen aeroplanët e pasagjerëve amerikane më 11 shtator 2001 tregojnë se këta njerëz ishin në gjendje të mirë financiare, me një nivel relativisht të lartë të arsimit, kanë jetuar për një kohë të gjatë në Perëndim, si dhe kanë qenë të njohur me vlerat e qytetërimit perëndimor.

Njëra nga bazat psikologjike për shkak të së cilës ekziston dëshira për të qenë një sulmues vetëvrasës është marrja e statusit e dëshmorit (të vdesin në mënyrë që të plotësojnë një urdhër fetar në luftën e shenjtë), e cila në vete përfshin lejimin se vrasësi i tillë, pas vdekjes, do të takohet me Allahun xh.xh dhe të marrë jetën e përjetshme në parajsë. Duke e marrë statusin shehid(dëshmorë) përmirësohet standardi shoqërorë i familjes së tij respektivisht vrasësit dhe ai më atë gjithashtu fiton respekt, status dhe shpërblim në të holla .

Terrorizmi vetëvrasës në të ardhmen do të jetë dominuese dhe në rritje, për shkak se më lehtë do të kryhet dhe do të arrihen efekte më të mëdha, nga që vdes dhe sulmues-vrasësi, i cili në mënyrë të konsiderueshme pengon zbulimin e bashkëpunësorëve dhe luftën kundra këtij lloji të terrorizmit.

Terrorizmi Socio-politik është një metodë e luftës politike për të mbajtur pushtetin, por edhe një metodë për të luftuar fuqinë e vazhdueshme, që do të thotë se terrorizmi si një mjet i luftës politike është i përdorur në mënyrë të barabartë edhe me ata që janë në pushtet, dhe me ata që nuk e janë në pushtet. Objektet e sulmit, respektivisht viktimat e terrorizmit mund të jenë të figurat e ndryshme politike, zyrtarët, gjyqtarët dhe prokurorët, zyrtarët e lartë ushtarak dhe diplomatik, bankat, stacionet policore, përfaqësitë, magazina dhe objektet të tjera publike. Përgjatë përzgjedhjes së viktimave, gjegjësisht objekteve kryhet i ashtuquajtur i terror selektiv.

Aktivitetet e tyre terroristët i kryejnë më atentate, rrëmbime ose marrje të pengjeve, rrëmbime të aeroplanëve, rrëmbime me shpërthime, zjarrvënie dhe diversione të tjera.

Qëllimet e terrorizmit janë shpesh herë të ngjyrosura politikisht dhe mund të jenë të ndryshme, duke filluar nga grabitjet e koncesioneve të caktuara, duke ndryshuar një pjesë të politikës së brendshme dhe të jashtme deri tek manifestimi i qartë dëshirës për të përmbytur regjimin, përkatësisht pushtimin e pushtetit.

Objektivat e kushtëzuara politike të veprimtarisë terroriste mund të klasifikohen në të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Qëllimet e tërthorta janë duke i dhënë një publicitet veprave të tyre dhe ideve, duke dëmtuar reputacionin ndërkombëtar të ndonjë shteti, duke shkaktuar surpriza të ndryshme

të detyruara, sigurimin e simpative të disa shtresave dhe masave të caktuara dhe duke bërë presion mbi ata që mbështesin veprimtarinë anti-terroriste.

Qëllimet përfundimtare mund të jenë konkrete (shkarkime dhe konsolidime të pushtetit politik në një shoqëri) ose jokonkrete (të sjellë revolucionin botëror në interpretimin e atyre grupeve terroriste qëllimet e të cilëve kapërcejnë kufijtë kombëtarë), me ç`rast duke mbajtur bazën transformohet në një tjetër formë të terrorizmit – Terrorizmi ndërkombëtar. Terrorizmi ndërkombëtar si një kategori historike paraqet një metodë ekstreme të dhunës me të cilën organizon një grup apo shoqatë, organizatë ose shtet gjegjësisht ndonjë prej organeve të tij, dhe të cilët kanë qëllimin e tyre, ideologjinë dhe planin, vazhdimisht përpiqen që nëpërmjet rrugës më të shkurtër ti arrijnë qëllimet e tyre, me anë të sulmeve kundra përfaqësuesve të qeverisë, simboleve shtetërore, por jo edhe përzgjedhjes së viktimave, dhe qëllimi kryesor është që të shkaktojnë frikësim.

Çdo formë e terrorizmit është e papranueshme, përfaqëson dukuri shoqërore negative dhe është i papajtueshme me qëllimet humanitare. Në kohët e fundit me shfaqjen dhe aplikimin e mjeteve luftarake modern, pasojat e ekzistencës së këtij lloji të terrorizmit janë disproporcionalisht më të mëdha se më parë. Frika nga terrorizmi ndërkombëtar sot ka arritur deri në masë që pritet dhe zbatimi i mjeteve luftarake nukleare me intensitet më të ulët për të arritur qëllimet e tyre, duke mos i kushtuar vëmendje rritjes së numrit të viktimave njerëzore dhe dëmeve materiale.

Terrorizmi ekonomikë po shfaqet si një lloj forme i terrorizmit i cili ka një rëndësi të madhe për ekzistencën e këtij fenomeni. Ai në fakt është fillimi dhe fundi i këtij fenomeni dhe definitivisht menaxhon me jetën e bartësve dhe mbështetësve të saj dhe jo politika apo ideologjia. Mungesa e përhershme e të hollave (para) çon në kërkim të vazhdueshëm të tyre. Terrorizmi është një sipërmarrje shumë e shtrenjtë dhe gjithmonë kërkon më shumë fonde për të siguruar mbijetesën e saj dhe në hapë me kohën. Të jetuarit ilegalisht është e rëndë , e cila e bën edhe më të vështirë sigurimin e burimeve të tilla të mëdha.

Preokupimi dhe detyra kryesore është sigurimi i këtyre fondeve, dhe jo udhëheqja e politikës apo ideologjisë me të cilën merret dhe të cilën e përcakton udhëheqësja

e e organizatës terroriste .e cila zakonisht përbëhet nga 5-7 njerëz ,përderisa të gjithë të tjerët janë të angazhuar në gjetjen e mjeteve të nevojshme.

Mund të thuhet se terrorizmi është një sipërmarrje biznesi, dhe si i tillë sigurisht që ka implikime në të gjitha sferat e jetës, me ç`rast krijon një sistem paralel alternativ ekonomik i cili ekziston përkrah nesh famshëm.

Nëse ekziston një sistem i tillë paralel ekonomik, atëherë do të thotë se ai është duke i ndjekur fazat e zhvillimit të sistemit ekonomik të sotëm. Kjo thekson se terrorizmi kalon nëpër tri faza për arsye se edhe sot e kësaj ai ditë është e qëndrueshëm dhe është në zhvillim. Faza e parë është se terrorizmi është nën patronazhin e shtetit, e dyta është, privatizimi i tij dhe i treti është globalizimi i tij.

Me ndryshimet të mëdha që me paraqitjen e globalizimit, grupet militante dhe organizatat janë të detyruara në lidhshmëri financiare dhe fillimin e marrëdhënieve me botën e krimit.

Me këtë u krijuan edhe organizatat transnacionale, si al-Kaeda, e cila mund të mbledhë të holla, pavarësisht nga kufijtë shtetërorë dhe është gjithashtu në gjendje për të kryer sulme terroriste në çdo vend. Vendosija e këtyre rikthen në lojë grabitjen ekonomike, e cila në fakt shfaqet në një kohë të ndryshimeve të mëdha, ku dhe globalizimi është një prej atyre ndryshimeve. Në raste të tilla politika nuk ka kontroll mbi ekonominë, ndërsa ekonomia shndërrohet në një forcë fraksioni që vepron kundër interesave të ligjshme. Disa vlerësime sugjerojnë se ky sistem ndërkombëtar ekonomik që e krijon krimin, terrorizmin dhe ekonominë ilegale ka asete prej 1.5 miliard dollarë.

Si është kjo e mundur? Shumica e parave janë futur në ekonominë amerikane, sepse pjesa më e madhe e parave kanë qenë të shprehur në dollarë amerikanë dhe larja e parave u zhvillua në po në Shtetet e Bashkuara. Vendi i hyrjes së këtyre parave ishin “kompanitë off-shore”. Kjo është një injeksion financiar me rëndësi jetike për ekonominë amerikane. Por dalja e këtyre parave nga shteti, në të holla natyrisht në çanta dhe kontenerë që kurrë nuk kthehen, është burimi i fondeve për rritjen e terrorizmit, ekonomisë ilegale dhe kriminale. Ky është rezultati i privilegjit të SHBA-ve të paraqesë thesarët shtetërore botërore dhe të shfrytëzojë të ar-

dhurat monetare. Asnjë vend tjetër në botë nuk mund ta bëjë këtë. Të gjitha shtetet e tjera vetëm mund të marrin hua, vetëm në shumën e shumës në qarkullim brenda kufijve të tyre. Nga kjo vijon se ekziston një implikim ndërmjet botës së krimit, terrorizmit dhe ekonomisë ilegale me ekonominë reale.

Element i rëndësishëm në të gjitha format e terrorizmit është dhuna e cila është një mjet për të arritur një qëllim të caktuar politik. Shikuar objektivisht, aktet terroriste i kryejnë grupet të vogla me mjete që janë në mospërputhje të madhe në raport me qëllimin. Konkluzioni i përgjithshëm është se me aplikimin e terrorizmit nuk mund të vijë deri tek ndryshimi i plotë i sistemit dhe i politikave globale të shteteve të caktuara. Historikisht nuk ka asnjë shembull ku terrorizmi ka çuar në një rebelim mbarëkombëtarë, por ai është i suksesshëm vetëm në raste dhe kushte të veçanta, kur veprojnë me objektiva të përcaktuara qartë.

Duke parë dimensionet e globalizimit dhe format e terrorizmit, ne mund të vijmë në përfundim se të dy fenomenet e sodit dhe pamundësia për definimin e tyre të përgjithshëm ndërmjet veti janë në garë me kohën dhe teknologjinë për mbijetesën e tyre progresive. Globalizimi konsiderohet si një përfitim i së sotshmes me të gjitha implikimet e tija të botës moderne, me rritjen më të dukshme të zhvillimit teknologjik, lëvizshmërinë e kapitalit, zhvillimin e aftësive IT, më shumë e zvogëlon rëndësinë e kufijve kombëtarë. Ai kontribuon në ndërvaresinë më të theksuar në bashkësinë ndërkombëtare.

Është reduktuar në mënyrë drastike mundësia e zgjidhjes së konflikteve ndërshtetërore me mjete ushtarake, veçanërisht në mesin e vendeve të zhvilluara. Modeli i ekonomisë së tregut, qeveritë demokratike, sollën ndryshime të reja në karakteristikat politike me ç`rast lidhja ekonomike gjithnjë e më shumë po ushtron presion mbi faktorin ushtarak si një mënyrë për zgjidhjen e problemeve.

Nga ana tjetër, ndjenja e madhe e pasigurisë që sjell terrorizmi, rezulton në një ri-konfirmim të sovranitetit të kombeve. Frika se standardet liberale i ndihmojnë terrorizmit nxit shtetet për të kontrolluar tregtinë ndër-kufitare.

Përpjekjet për të parandaluar terroristët të transportojnë burimet e tyre çojnë në një kontroll më të madh të bankave dhe vënien e masave të

reja që mund të ngadalësojë rrjedhjen e kapitalit, por jo edhe ta ndalojnë. Shtetet përforcojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për të monitoruar rrjedhën e informacioneve, njerëzve dhe të hollave përtej kufijve. Masat e shtuara janë produkt i ndryshimeve në prioritet. Vendi kryesor në prioritetet e shteteve sot e merr sigurinë dhe kërkimi pas saj, ndërsa profiti sakrifikohet fitimet për të.. Kjo mund të çojë deri në stagnimin e globalizimit, ndërsa mjetet për shpejtësinë e tij do të reduktohen.

Fenomeni i globalizimit me siguri e ka globalizuar dhe fenomenin e terrorizmit, por në drejtim total të kundërt diametral.

Ironikisht është terrorizmi global - një fenomen në të cilin terroristët punojnë së bashku ose kundër kombeve të shumta në të njëjtën kohë - është i ndihmuar nga globalizimi dhe tani është sfida më e madhe e tij. . Terrorizmi global varet nga suksesi i globalizimit. Në fakt, terrorizmi global mund të kuptohet nga perspektiva e kulturës globale, e cila pra buron nga globalizimi. Kjo mund të jetë e rëndësishme se në qoftë se ne dëshirojmë të shtypim terrori globale duhet përsëri të kthehemi në sovranitetin e shtetit dhe në ndërtimin e sigurisë kombëtare të shtetit. A mund të lejohet kjo duke e ditur se të gjitha ekonomitë e avancuara varen kryesisht nga tregtia ndërkombëtare. Kapitali global i shijoi frytet e fitimeve dhe nuk ka gjasa që të braktisë atë.

Nëse ndërvaresia e globalizimit dhe terrorizmit botëror është e pathyeshme, dhe në qoftë se globalizimi është duke ndihmuar terrorizmin, a do të thotë kjo se nuk ka zgjidhje tjetër, përveç se të jetohet me terrorizmin global? A do të duhet të jetohet në një botë globale duke shijuar frytet e tij nga bashkëpunimi dhe nga tregtia ndërkombëtare, por edhe me frikën nga kthimi i papritur i dhunës politike? Është e mundur që terrorizmi global të jap impuls për përshpejtim të procesit të globalizimit, i cili proces do të këmbëngulë që të gjejë masa adekuate për stagnimin e tij dhe vënien nën kontroll.

Kush kë ndihmon dhe inicon zhvillimin e tij të shpejtë? Kush në mënyrë të përshtatshme i përdorë arritjet në shkencë për realizimin e qëllimeve të tyre? Është i mundur ekuilibri në garën me qëllimet diametralet? Çfarë është trajektorja e suksesit për ruajtjen e vlerave thelbësore? Përgjigjet janë në thelbin e dukurive të globalizimit dhe terrorizmi, dimensionet e tyre dhe manifestimeve, si dhe lidhja reciproke e tyre inerte që lejon mbijetesën sigurtë.

NJOFTIM

Në kuadër të 100- vjetorit të Pavarësisë dhe krijimit të FA-së të RSH, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes organizon aktivitetin “Talentet brenda radhëve të FA-së”. Ftojme të gjithë personelin e FA-së që kanë prirje artistike në: instrumente të ndryshme, këngë dhe kërcim; aktrim-recitim; art figurativ-pikturë; gdhendje, skulpturë; të kontaktojnë me zyrën e Marrëdhënieve me Komunitetin.

Jeni të mirepritur deri më 28 Nentor 2012
Faleminderit!

Tel zyre (510) 15 31, Cel: 066 40 90 589

SEKTORI I REKREACIONIT

DREJTORIA E AKTIVITETEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME KOMUNITETIN

NJOFTIM

QENDRA E KULTURËS, MEDIAS
DHE E BOTIMEVE TË MBROJTJES

Në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë dhe krijimit të Forcave të Armatosura Shqiptare : Shpall konkursin me krijimet më të arrira në fushën e letërsisë (poezi, tregim, novelë), si dhe konkursin për fotografinë më të mirë të bërë nga jeta dhe veprimtaria e FA. Materialin konkurruar mund ta dorëzoni çdo ditë pranë

QKMBM, ose mund ta dërgoni në adresën
europress2000@gmail.com

Shpallja e fituesve do të bëhet më datë 01.12.2012
DREJTORIA E AKTIVITETEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME
KOMUNITETIN SEKTORI I AKTIVITETEVE